



Rrjeti i Grave të Kosovës  
Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

KVINNA  
KVINNA

Sweden  
Sverige

## KOMENT SHPJEGUES

# LEXIM NGA PERSPEKTIVA GJINORE I RAPORTIT TË KOMISIONIT EVROPIAN 2024 PËR KOSOVËN



## Përmbajtja

<b>HYRJE.....</b>	<b>3</b>
<b>PËRMBLEDHJE: PËRFSHIRJA E PERSPEKTIVËS GJINORE NË RAPORT .....</b>	<b>3</b>
<b>KAPITUJT QË TRAJTOJNË BARAZINË GJINORE.....</b>	<b>4</b>
GJETJET KRYESORE TË RAPORTIT .....	4
2. BAZAT E PROCESIT TË ANËTARËSIMIT .....	5
2.2. SUNDIMI I LIGJIT DHE TË DREJTAT THEMELORE.....	5
2.3. ZHVILLIMI EKONOMIK DHE KONKURRUESHMËRIA.....	6
2.4. PROKURIMI PUBLIK, STATISTIKAT, KONTROLLI FINANCIAR .....	6
5. STANDARDET EVROPIANE.....	6
GRUPIMI 3: KONKURRENCA DHE RITJA PËRFSHIRËSE .....	6
<b>MANGËSITË NË PËRFSHIRJEN E PERSPEKTIVËS GJINORE NË RAPORT SI DHE</b>	
<b>REKOMANDIMET PËR PËRMIRËSIMIN E SAJ .....</b>	<b>7</b>
GJETJET KRYESORE TË RAPORTI .....	7
2. BAZAT E PROCESIT TË ANËTARËSIMIT .....	9
2.1. FUNKSIONIMI I INSTITUCIONEVE DEMOKRATIKE DHE REFORMA E ADMINISTRATËS PUBLIKE.....	9
2.2. SUNDIMI I LIGJIT DHE TË DREJTAT THEMELORE.....	10
2.3. ZHVILLIMI EKONOMIK DHE KONKURRUESHMËRIA.....	11
2.4. PROKURIMI PUBLIK, STATISTIKAT, KONTROLLI FINANCIAR .....	12
3. MARRËDHËNIET E MIRA FQINJËSORE DHE BASHKËPUNIMI RAJONAL .....	12
4. NORMALIZIMI I MARRËDHËNIEVE NDËRMJET KOSOVËS DHE SERBISË .....	12
5. STANDARDET EVROPIANE.....	13
GRUPIMI 2: TREGU I BRENDSHËM.....	13
GRUPIMI 3: KONKURRUESHMËRIA DHE RITJA GJITHËPËRFSHIRËSE .....	13
GRUPIMI 4: AGJENDA E GJELBËR DHE LIDHSHMËRIA E QËNDRUESHME .....	15
GRUPIMI 5: RESURSET, BUJQËSIA DHE KOHEZIONI .....	15
GRUPIMI 6: MARRËDHËNIET E JASHTME .....	15
SHTOJCA I –MARRËDHËNIET NDËRMJET BE-së DHE KOSOVËS .....	15
SHTOJCA II - TË DHËNA STATISTIKORE.....	16
<b>REKOMANDIMET KRYESORE PËR KOMISIONIN EVROPIAN .....</b>	<b>16</b>
<b>SHTOJCA 1. VLERËSIMI SIPAS QASJES “DRITAT E SEMAFORIT” .....</b>	<b>17</b>

Ky material është financuar nga Suedia dhe fondacioni Kvinna till Kvinna, të cilët nuk pajtohen domosdoshmërisht me qëndrimet e shprehura në të. Për përmbajtjen janë përgjegjëse vetëm autoret.

## HYRJE

Çdo vit, Komisioni Evropian (KE) paraqet vlerësimin e tij për progresin e Kosovës drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian (BE) përmes një raporti (në tekstin e mëtejshëm: “Raporti”). Sipas zotimeve të BE-së, idealisht, të gjithë kapitujt e Raportit duhet të përfshijnë perspektivën gjinore. Çdo vit, Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) harton një koment shpjegues mbi mënyrën se si Raporti i Progresit për Kosovën i trajton çështjet e barazisë gjinore.<sup>1</sup> Ky koment shpjegues analizon Raportin e KE-së për Kosovën për vitin 2023 nga perspektiva gjinore,<sup>2</sup> duke shqyrtuar fokusin e tij ndaj grave, burrave, vajzave, djemve dhe barazisë gjinore; si dhe sa janë përfshirë rekomandimet e ofruara nga organizatat e shoqërisë civile për të drejtat e grave (OSHCG-të).<sup>3</sup> Ky koment shqyrton se si është përfshirë aspekti gjinor në raport dhe rekomandon mënyra për KE-në që të integrojë më mirë këtë aspekt në kapitujt dhe seksionet e ndryshme. Shtojca I përmban një analizë të përfshirjes së perspektivës gjinore për secilin kapitull përmes një metodologjie të “semaforit”.

## PËRMBLEDHJE: PËRFSHIRJA E PERSPEKTIVËS GJINORE NË RAPORT

Në përgjithësi, Raporti përmend gratë, burrat, barazinë gjinore dhe gjininë dukshëm më pak se në vitet e mëparshme, duke arritur në vetëm 84 herë, krahasuar me 150 herë në vitin 2023 dhe 120 herë në vitin 2022. Raporti i vitit 2024 e ka integruar perspektivën gjinore në një kapitull (3%), pjesërisht në nëntë kapituj (24%) dhe aspak në 27 kapituj (73%).<sup>4</sup> Në të janë integruar përafërsisht 43% të rekomandimeve të RrGK-së dhe anëtarëve të saj, duke shënuar një rënie të konsiderueshme në krahasim me Raportin e vitit të kaluar, i cili kishte përfshirë afërsisht 70% të rekomandimeve të RrGK-së. Gjetjet e tjera kryesore përfshijnë:

Termi	2022	2023	2024
Gra/Gratë	57	57	29
Burra/t	3	8	2
Vajza/ë	4	5	5
Djali/ë	0	0	0
Femër	12	18	6
Mashkull	6	13	6
Gjinia	38	49	36
<b>Gjithsej</b>	<b>120</b>	<b>150</b>	<b>84</b>

- **Pesë nga 114 rekomandimet (4%) lidhen drejtpërdrejt me avancimin e barazisë gjinore.** Lidhur me to, KE-ja ka prirjen të shprehë se rekomandimet e vitit të kaluar janë zbatuar pjesërisht dhe mbeten përgjithësisht të vlefshme. Rekomandimet kryesore për barazinë gjinore përfshijnë:
  - 1) Te **gjqësori** të “sigurohen hetime solide penale, të përmirësohet cilësia e aktakuzave dhe të sigurohet procedura penale efektive, përfshirë rastet e dhunës me bazë gjinore”.
  - 2) Në pjesën për **të drejtat themelore**, “të forcohet zbatimi i Ligjit për barazinë gjinore dhe i Strategjisë për dhunën me bazë gjinore; të emërohet një drejtues i ri i Agjencisë për Barazi Gjinore; dhe të përmirësohet integrimi gjinor në legjislacionin, rregulloren dhe politika.”
  - 3) Në pjesën për **luftën kundër krimit të organizuar**, të “forcohen përpjekjet për të parandaluar dhe luftuar kontrabandën e migrantëve dhe trafikimin e qenieve njerëzore” megjithatë nuk u përmend fakti se gratë dhe vajzat përbëjnë shumicën e personave të trafikuar.
  - 4) Në pjesën për **politikën sociale dhe punësimin**, të “miratohet Ligji për punësimin dhe ndryshimet në Ligjin e punës për të harmonizuar kornizën ligjore me legjislacionin (acquis) e BE-së,

<sup>1</sup> RrGK është një rrjet multietnik dhe i larmishëm, i përbërë nga 143 organizata anëtare në të gjithë Kosovën. Kjo përmbledhje është shkruar nga Nicole Farnsworth dhe Eleta Shala për RrGK-në, duke përdorur të dhëna nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGj)

KE, [Raporti i Kosovës 2024](#). Këtë vit, KE ka bërë disa ndryshime në formatin e Raportit. Në shkallën 6-pikëshe që vlerëson progresin, ose mungesën e tij, ndryshimi midis progresit të kufizuar dhe atij të caktuar nuk është plotësisht i qartë (f. 4). Gjetjet dhe rekomandimet kryesore janë paraqitur fillimisht në seksionin “Gjetjet kryesore të raportit”, dhe më pas Raporti ofron analiza të mëtejshme.

<sup>3</sup> RrGK u konsultua me organizatat e saj anëtare dhe ofroi të dhëna për Raportin e këtij viti në prill 2024. Anëtarët e RrGK-së që kontribuuan përfshijnë: QKSGj-në dhe Shoqatën e Grave të Mitrovicës për të Drejtat e Njeriut.

<sup>4</sup> Shih Shtojcën I.

veçanërisht në lidhje me mosdiskriminimin në punësim dhe pushimin prindëror”, megjithëse do të ishte e dobishme një referencë më e qartë për pushimin e lehonisë, atësisë dhe atë për kujdestarët. Rekomandimet e tjera në këtë seksion kanë të bëjnë me të drejtat e grave dhe barazinë gjinore, por kjo nuk është shprehur në mënyrë eksplicite.

- 5) Në pjesën për **shkencën dhe hulumtimin**, të “hartohet dhe zbatohet një strategji gjinore për hulumtimin në nivel kombëtar, si dhe për integrimin dhe promovimin e plotë të grave dhe vajzave në shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë”.

Ka pasur mundësi për rekomandime shtesë për t’iu referuar barazisë gjinore, siç shtjellohet në seksionet e mëvonshme të këtij Komenti shpjegues.

- **Në më pak kapituj është integruar perspektiva gjinore:** Raporti i këtij viti nuk ka përfshirë vëmendjen ndaj aspektit gjinor në lidhje me shumë çështje të rëndësishme, siç përshkruhet më poshtë. Format i ri i raportit, me gjatësinë e reduktuar, mund të ketë ndikuar në cilësinë dhe sasinë e analizës gjinore; megjithatë, në disa seksione mund të ishin shtuar një deri në tre fjalë, gjë që do ta bënte raportin më të përgjegjshëm gjinor
- **Përfshirja e pamjaftueshme e të dhënave të ndara sipas gjinisë** në disa kapituj..
- **Qasja joadekuate ndërthurëse:** Sa i përket banorëve ruralë, fëmijëve, pakicave (veçanërisht serbëve, romëve, ashkalive dhe egjiptianëve), personave me aftësi të kufizuara dhe individëve LGBTQI+ (lezbikë, homoseksualë, biseksualë, trans+, queer, interseksualë dhe të tjerë me identitete të ngjashme), raporti nuk është i ndarë sipas gjinisë ose seksit. Vëmendja ndaj djemve mbetet minimale.
- **Regresioni i përgjithshëm:** Edhe pse Raporti i vitit 2023 demonstroi disa përmirësime në integrimin gjinor, Raporti i vitit 2024 ka treguar regres në këtë drejtim.

## KAPITUJ T QË TRAJTOJNË BARAZINË GJINORE

Raporti i këtij viti i referohet çështjeve gjinore në disa seksione kryesore, siç vijon:

### GJETJET KRYESORE TË RAPORTIT

Referencat për barazinë gjinore në seksionin e gjetjeve kryesore të Raportit janë të rëndësishme, sepse ato inkurajojnë autoritetet qeveritare, ndër të tjera, që t’i japin përparësi avancimit të barazisë gjinore. Seksionet e mëposhtme të gjetjeve kryesore përfshijnë çështjet e barazisë gjinore:

- Lidhur me **bazat e procesit të anëtarësimit**, në kuadër të pjesës për **demokraci dhe qeverisje**, KE vërejti “progres të prekshëm në përmirësimin e barazisë gjinore si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal”.
- Në **Kapitullin 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore:**
  - Lidhur me **funksionimin e gjyqësorit**, raporti theksoi se “puna ka vazhduar për trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore, por nevojitet progres më i shpejtë”.
  - U përfshi një **rekomandim** për të “siguruar hetime solide penale, përmirësuar cilësinë e aktakuzave dhe siguruar procedura penale efektive, duke përfshirë rastet e dhunës me bazë gjinore”.
  - Në lidhje me **të drejtat themelore**, KE vërejti se Kosova “ka caktuar një koordinator kombëtar dhe ka themeluar sekretariatit qendror për luftimin e dhunës me bazë gjinore”..
  - Raporti vuri në dukje çështjen kyçe se “Miratimi i Kodit Civil mbetet pezull”, e cila lidhet me disa aspekte të barazisë gjinore, megjithëse këto nuk janë përmendur në mënyrë eksplicite.
  - Në një **rekomandim** për Qeverinë kërkohet “të fuqizohet zbatimi i Ligjit për Barazi Gjinore dhe Strategjisë për Dhunën me Bazë Gjinore; të emërohet një udhëheqës i ri për Agjencinë për Barazi Gjinore; dhe të përmirësohet përfshirja e perspektivës gjinore në legjislacion, rregullore dhe politika”.
- Në **Kapitullin 24: Drejtësia, liria dhe siguria**, në lidhje me **luftën kundër krimit të organizuar**, vërehet përparim në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Në një **rekomandim** thuhet të “forcohen



përpjekjet për të parandaluar dhe luftuar kontrabandën dhe trafikimin e qenieve njerëzore.”

- Në **Grupimin 3: Konkurrueshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse:**
  - **Në Kapitullin 19 – Politika Sociale dhe Punësimi rekomandohet** të “miratohet Ligji për punësimin dhe ndryshimet e plotësimet Ligjit të punës për të harmonizuar kornizën ligjore me legjislacionin (acquis-in) e fundit të BE-së, veçanërisht në lidhje me mosdiskriminimin në punësim dhe pushimin prindëror”, megjithëse nuk përmenden qartë pushimi i lehonisë, i atësisë, pushimi për kujdestarët ose aspekte të tjera të ligjeve që prekin barazinë gjinore.
  - **Në Kapitullin 25 – Shkenca dhe hulumtimi rekomandohet** të “hartohet dhe zbatohet strategjia gjinore për hulumtime në nivel kombëtar, si dhe për integrimin dhe promovimin e plotë të grave dhe vajzave në shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë”

## 2. BAZAT E PROCESIT TË ANËTARËSIMIT

### 2.1. FUNKSIONIMI I INSTITUCIONEVE DEMOKRATIKE DHE REFORMA E ADMINISTRATËS PUBLIKE

#### 2.1.1 Demokracia

- Sa i përket **zgjedhjeve**, në Raport thuhet: “Ndonëse ende të nënpërfaqësuar, gratë luajnë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në vendimmarrje. Kuadri ligjor zgjedhor parashikon një kuotë gjinore prej të paktën 30% për Kuvendin, ndërsa rregulli i përfaqësimit të barabartë i Ligjit për barazinë gjinore përcakton një kuotë prej 50%. Avokati i Popullit e ka dërguar ligjin e ri për zgjedhje në Gjykatën Kushtetuese për të sqaruar këtë mospërputhje.” Ky seksion përfshin gjithashtu një grafik mbi pjesëmarrjen e grave në politikë.:
- Sa i përket **qeverisjes**, aty thuhet se: “Kosova ka bërë përparim në përmirësimin e barazisë gjinore në nivel lokal, pasi 16 komuna kanë zhvilluar analiza gjinore specifike për sektorët dhe kanë funksionalizuar një kornizë buxhetore afatmesme gjithëpërfshirëse gjinore, si dhe 16 plane veprimi.” Megjithatë, kuptimi i termit “funksionalizuar” mbetet i paqartë; monitorimi i RrGK-së sugjeron se disa komuna ende nuk po e zbatojnë në mënyrë të përshtatshme buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, përfshirë edhe në buxhetet e tyre vjetore
- Për **shoqërinë civile**, në Raport shtjellohet se “do të ishte e dobishme të rriteshin konsultimet me OSHC-të që avokojnë për të drejtat e grave.”

#### 2.1.2 Reforma e administratës publike

- Për **zhvillimin dhe koordinimin e politikave**, thuhet: “Nuk ka pasur përparim në përfshirjen e elementeve gjinore në të gjitha politikatat, apo në zhvillimin e politikave dhe legjislacionit gjithëpërfshirës dhe të bazuar në dëshmi”
- Për **menaxhimin e financave publike**, Raporti vë në dukje: “Rregullat e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor, të kërkuara nga qarkoret buxhetore, nuk janë të përfshira në legjislacion dhe nuk janë të disponueshme për publikun.
- Për **shërbimin civil**, thuhet: “Numri i grave në pozita të larta mbetet i pakënaqshëm”.

### 2.2. SUNDIMI I LIGJIT DHE TË DREJTAT THEMELORE

#### 2.2.1 Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore

- Në pjesën për **funksionimin e gjyqësorit**, në lidhje me organet menaxhuese, në raporti thuhet se “KPK dhe KGJK kanë emëruar zëvendëskryetarë të rinj, të dyja gra”
  - Për sa i përket trajtimit të rasteve të krimeve të luftës dhe personave të zhdukur, vërehet përparim në hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të dhunës seksuale.
- Në pjesën për **të drejtat themelore**, në lidhje me parandalimin e torturës dhe keqtrajtimit, Raporti thekson se “është e nevojshme të ndërmerren veprime për të mbrojtur të drejtat e të burgosurve, veçanërisht grave, vajzave, anëtarëve të komuniteteve jo-shumicë dhe të burgosurve me probleme mendore”.

- Në pjesën për **lirinë e shprehjes**:
  - Në seksionin për **mbrojtjen e gazetarëve** thuhet se “gratë gazetare janë më shpesh në shënjestër të sulmeve sesa gazetarët burra”.
  - **Sa për transmetuesin publik**, RTK, KE-ja thekson se “janë paraqitur tri ankesa kundër menaxhmentit për diskriminim gjinor”.
  - Seksioni për **lirinë e tubimit dhe të asociimit** thekson se “Gjatë Paradës së Krenarisë LGBTIQ së mbajtur në Prishtinë në qershor 2024 nuk pati ndonjë incident”.
  - Tek pjesa për **të drejtat pronësore**, Raporti thekson: “Qeveria vazhdoi masat afirmative për regjistrimin e pronësisë së përbashkët nga bashkëshortët në regjistrin e të drejtave pronësore, duke synuar rritjen e numrit të grave pronare. Megjithatë, përqindja e grave pronare të pronave mbetet e ulët (19.82% e pronave të regjistruara).”
  - Seksioni për **barazinë gjinore** trajton disa çështje të rëndësishme, duke përfshirë ato që lidhen me qeverisjen, kapacitetet, planifikimin e programeve, përfshirjen e perspektivës ligjore në ligje/politika, nevojën për një plan të ri veprimi për Gratë, Paqen dhe Sigurinë (GPS), martesat e hershme brenda disa grupeve etnike dhe dhunën me bazë gjinore..
  - Për **personat me aftësi të kufizuara**, KE-ja thekson se “shërbimet shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara kanë nevojë për përmirësim në përgjithësi dhe posaçërisht për gratë dhe vajzat”.
  - Në seksionin për **personat LGBTIQ** përmenden disa çështje kyçe, duke përfshirë Kodin Civil, Ligjin për Gjendjen Civile dhe diskriminimin e vazhdueshëm..
  - Për **të drejtat procedurale dhe të drejtat e viktimave**, KE-ja thekson: “Pavarësisht zgjerimit të ndihmës juridike falas për të gjitha gratë viktimë të dhunës me bazë gjinore, shumë pak prej tyre janë të përfaqësuara në proceset gjyqësore”

### 2.3. ZHVILLIMI EKONOMIK DHE KONKURRUESHMËRIA

- Tabela fillestare përfshin të dhëna të ndara sipas gjinisë mbi aktivitetin dhe shkallën e papunësisë..

#### 2.3.1. Ekzistimi i një ekonomie funksionale të tregut

- Në seksionin për **funksimin e tregut të punës**, theksohet se “hendeku gjinor në punësim (normat janë 53,4% për burrat dhe 19,8% për gratë) është zgjeruar.”

### 2.4. PROKURIMI PUBLIK, STATISTIKAT, KONTROLI FINANCIAR

#### Kapitulli 18 – Statistikat

- Në Raport theksohet se “ASK duhet të përmirësojë mbledhjen dhe përpilimin e të dhënave të ndara sipas gjinisë. Kosova nuk ka Indeks të Barazisë Gjinore.

## 5. STANDARDET EVROPIANE

### GRUPIMI 3: KONKURRENCA DHE RRITJA PËRFSHIRËSE

#### Kapitulli 19 – Social Politika sociale dhe punësimi

- Raporti thekson se 'përpjekjet për të adresuar **diskriminimin ndaj grave në punësim dhe në politikat sociale**, veçanërisht gjatë procedurave të punësimit, promovimit dhe pagave, janë të kufizuara.' Ai shton se 'Mungesa e objekteve për kujdes ndaj fëmijëve dhe të moshuarve, ndarja e pabarabartë e përgjegjësisë në pushimin e lehonisë, atësisë dhe pushimin prindëror pengojnë punësimin e grave. Ndërprerja e periudhës së provës për shkak të shtatzënisë nuk trajtohet si diskriminim i drejtpërdrejtë. Inspektorët e punës dhe gjyqtarët kanë mungesë njohurish për të trajtuar më mirë çështjet e diskriminimit me bazë gjinore.' Për më tepër, Raporti përmban të dhëna të ndara sipas gjinisë për aktivitetin ekonomik dhe normat e papunësisë.

#### Kapitulli 20 – Politika për ndërmarrjet dhe industri

- Përmenden ër kreditë e Fondit Kosovar të Garancisë Kreditore, të ofruara për bizneset në pronësi të grave.

#### Kapitulli 25 –Shkenca dhe hulumtimi

- **Në raport theksohet:** “Edhe pse nuk ka një plan të qartë për miratimin e një strategjie gjinore, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit vazhdon të mbështesë studentet që dëshirojnë të studiojnë shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë përmes një programi bursash.” Mund të ishin përfshirë më shumë të dhëna.

#### Kapitulli 26 Arsimi dhe kultura

- Vetëm paragrafi për arsimin dhe aftësimin profesional (AAP) i referohet shkurtimisht përmirësimit të “punësueshmërisë së djemve dhe vajzave të reja”.

## MANGËSITË NË PËRFSHIRJEN E PERSPEKTIVËS GJINORE NË RAPORT SI DHE REKOMANDIMET PËR PËRMIRËSIMIN E SAJ

Ky seksion sugjeron mënyrat se si mund të ishte integruar më tej aspekti gjinor në raport, duke e paraqitur atë sipas seksioneve dhe kapitujve të raportit.

### GJETJET KRYESORE TË RAPORTI

- Në pjesën për **Bazat e Procesit të Anëtarësimit:**
  - Për *Kuvendin*, në rekomandimet për përmirësimin e procesit legjislativ, KE-ja mund të kishte inkurajuar kërkesën për vlerësime të ndikimit gjinor.
- Te **reforma e administratës publike**, KE-ja mund të kishte promovuar masa afirmative për barazinë gjinore si pjesë të rekrutimit të bazuar në merita. Rekomandimet e KE-së për digjitalizimin e shërbimeve civile gjithashtu mund të kishin përfshirë nxitjen e një [digjitalizimi gjithëpërfshirës dhe të përgjegjshëm gjinor](#). Rekomandimi për "rishikimin e legjislacionit për menaxhimin e financave publike" duhet të përfshinte buxhetimin e përgjegjshëm gjinor dhe publikimin e deklaratës së buxhetit gjinor si pjesë të dokumentacionit buxhetor, në përputhje me [Kornizën Gjinore](#) për Shpenzimet Publike dhe Përgjegjësinë Financiare ([PEFA](#)) dhe Objektivin për Zhvillimin e Qëndrueshëm ([OZHQ](#)) 5.c.i.
- Në **Kapitullin 23: Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore:**
  - Lidhur me *të drejtat themelore*, rekomandimi për përmirësimin e mbrojtjes për "të drejtat e personave me aftësi të kufizuara" është i mirëpritur dhe mund të përfshinte më tej nevojën për sigurimin e pagave të drejta për asistentët personalë me pagë minimale, duke përfshirë kontributet e pensioneve – [një çështje që prek në veçanti gratë](#).
  - Sa i përket *lirisë së shprehjes*, KE-ja mund të kishte theksuar se Ligji i ri për Komisionin e Pavarur të Mediave (KPM) duhet të sigurojë një ekuilibër gjinor në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore (LBGJ). Gjithashtu, KE-ja mund të kishte pranuar rekomandimet nga shoqëria civile lokale, përveç atyre nga aktorët ndërkombëtarë.
- Në **Kapitullin 24: Drejtësia, liria dhe siguria:**
  - KE-ja mund të kishte përfshirë në rekomandimin e saj që zbatimin e politikës së migracionit të jetë i përgjegjshëm ndaj aspektit gjinor dhe moshës.
  - Në kuadër të *luftës kundër krimit të organizuar*, teksa KE-ja rekomandon një ekuilibër etnik në polici, ai mund të kishte sugjeruar edhe balancën gjinore.
- Tek **ekzistimi i një ekonomie tregu funksionale** u vu re përparimi në tregun e punës, por vazhdon të ketë nën-përfaqësim të grave. [Taksat](#), menaxhimi i investimeve publike, rezultatet e tregut të punës dhe [joformaliteti](#) mund të adresonin më mirë dallimet gjinore dhe nevojën për buxhetim të përgjegjshëm gjinor.

- Lidhur me **kapacitetin për të përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregut në BE:**
  - Referencat për sistemin e dobët arsimor dhe rekomandimet përkatëse mund të përfshinin nevojën për edukim transformues gjinor, që synon ndryshimin e stereotipeve profesionale dhe eliminimin e [segregimit gjinor](#), duke përgatitur gratë dhe burrat për t'u angazhuar në sektorë të ndryshëm.
  - Vëmendja ndaj digjitalizimit të ekonomisë mund të përfshinte kërkesën për një [digjitalizim të përgjegjshëm gjinor](#)
  - Observimet për sfidat që hasin firmat e vogla dhe mikro në konkurrencë mund të kishin theksuar specifikisht tendencën e grave për të drejtuar firma të vogla që [përballen me vështirësi në konkurrencë](#)
- **Kapitulli 5 – Prokurimi publik:** Mund të përmendej shkurtimisht dështimi në zbatimin e prokurimit të përgjegjshëm gjinor, duke përdorur masat afirmative të parashikuara nga ligji. Rekomandimi duhet të përfshinte integrimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në ligjin e ri për prokurimin publik.
- **Kapitulli 18 – Statistikat:** Mund të përmendej mungesa e statistikave të ndara sipas gjinisë, duke rekomanduar përmirësimin e disponueshmërisë së të dhënave të tilla administrative, përparimin në krijimin e Indeksit të Barazisë Gjinore, dhe forcimin e kapaciteteve për analizën gjinore në Agjencinë e Statistikave të Kosovës (ASK).
- **Kapitulli 32 – Kontrolli financiar:** Mund të theksohej nevoja për përmirësimin e mbikëqyrjes parlamentare të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor, integrimin e këtij buxheti në ligjin e ri për menaxhimin e financave publike, dhe sigurimin që parlamenti dhe menaxherët e buxhetit të kenë kapacitetet e nevojshme për të mbikëqyrur zbatimin e detyrimeve për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor.
- Në kuadër të **Grupimit 2: Tregu i brendshëm, Kapitulli 8 – Politika e konkurrencës:** Diskutohej ndihma shtetërore, ku mund të theksohej nevoja për një qasje të përgjegjshme gjinore.
- **Kapitulli 28 – Mbrojtja e konsumatorit dhe shëndetit:** Mund të theksohej nevoja për një qasje të përgjegjshme gjinore ndaj mbrojtjes së konsumatorit, mbulimit shëndetësor universal që përfshin edhe personat që kryejnë punë të papaguar në shtëpi (kryesisht gratë), në përputhje me Ligjin për Barazinë Gjinore, si dhe për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore. Gjithashtu, është shqetësues fakti që theksi i KE-së mbi mbrojtjen e shëndetit trajtohet vetëm në kontekstin e mbrojtjes së kapitalit njerëzor për të "siguruar rritjen ekonomike në të ardhmen", dhe jo si një çështje e të [drejtave](#) të njeriut.
- Tek **Grupimi 3: Konkurrueshmëria dhe Rritja Gjithëpërfshirëse, Kapitulli 10: Transformimi digjital dhe mediat** mund të ishte theksuar nevoja për strategji më të përgjegjshme gjinore për [e-qeverisjen](#) dhe sigurinë kibernetike.
- Te **Kapitulli 16– Vënia e tatimeve** mund të përfshihej në rekomandime nevoja për politika tatimore të përgjegjshme gjinore, përpjekjet për të adresuar ekonominë joformale, dhe për realizimin e një rekrutimi të balancuar gjinor nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), duke përdorur masa afirmative, vlerësime gjinore të performancës, promovim dhe zhvillim kapacitetesh për inspektime të përgjegjshme gjinore.
- Te **Kapitulli 17 – Politika ekonomike dhe monetare** mund të përmendej buxhetimi i përgjegjshëm gjinor në lidhje me parashikimet makroekonomike në procesin buxhetor.
- Në **Kapitullin 19 – Politika sociale** dhe punësimi rekomandohet nevoja për ndryshimin e ligjit të punës për të siguruar mosdiskriminim dhe pushim prindëror, por mund të përfshihej edhe pushimi i atësisë dhe ai i kujdestarit. Edhe pse sugjerohet përmirësimi i *inspektimeve të punës* në sektorët me "rrezik të lartë," nuk përmendet qasja e përgjegjshme gjinore. Nuk sugjerohet një *ligj dhe strategji punësimi e përgjegjshme gjinore*, duke marrë parasysh nën-përfaqësimin e konsiderueshëm të grave në fuqinë punëtore, ose një *ligj i përgjegjshëm gjinor për shëndetin dhe sigurinë në punë*. Rekomandohet që *reformat e asistencës sociale dhe shërbimeve* të jenë pro të varfërve, por jo të përgjegjshme gjinore. Përmenden *shërbimet* për fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara, por jo për të mbijetuarit/at [e dhunës me bazë gjinore](#). Nuk përmendet siguria e [asistentëve personalë për](#) personat me aftësi të kufizuara, me kapacitete adekuate dhe paga në përputhje me pagën minimale. Po ashtu, nuk



përmendet nevoja për buxhetim të përgjegjshëm gjinor nga komunat për **planifikimin dhe ekzekutimin e buxhetit social**.

- Në **Kapitullin 20 – Politika për ndërmarrjet dhe industri** mund të përfshihej rekomandimin për një strategji të përgjegjshme gjinore dhe mbështetje për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM).
- **Kapitulli 26 – Arsimi dhe kultura** mund të përmendte shkurtimisht nevojën për arsim të përgjegjshëm gjinor, veçanërisht në arsimin e hershëm, kurrikulat dhe trajnimin e mësuesve për transformimin e normave dhe avancimin e barazisë gjinore.
- Në **Grupimin 4: Agjenda e Gjellbër dhe Lidhshmëria e Qëndrueshme, Kapitulli 14 – Politika e transportit** mund të ishte përmendur nevoja për një strategji gjithëpërfshirëse dhe të përgjegjshme gjinore për lëvizshmërinë, si dhe një plan veprimi; përfshirë një ligj të përgjegjshëm për rrugët, inspektimet, të dhënat e aksidenteve, planin e veprimit për transportin inteligjent dhe të drejtat e pasagjerëve.
- **Te Kapitulli 15 – Energjia** mund të ishin rekomanduar ligje, strategji dhe investime për efikasitetin energjetik që janë të përgjegjshme gjinore.
- **Te Kapitulli 21 – Rrjetet Trans-Evropiane** mund të ishin kërkuar projekte infrastrukturore që janë të përgjegjshme gjinore.
- Në **Kapitullin 27 – Mjedisi dhe ndryshimet klimatike** mund të ishin rekomanduar ligje, strategji dhe kapacitete të burimeve njerëzore që reflektojnë përgjegjshmëri gjinore.
- **Te Grupimi 5: Burimet, Bujqësia dhe Kohezioni, Kapitulli 11 – Bujqësia** mund të ishin rekomanduar ligje që janë të përgjegjshme gjinore dhe përfshirja e ekspertizës gjinore në lidhje me ndërtimin e kapaciteteve.
- **Te Kapitulli 12 – Siguria ushqimore, politikat veterinarë dhe fitosanitare** mund të ishte përmendur balanca gjinore në staf dhe ekspertiza gjinore midis tyre.
- **Te Kapitulli 22 – Politika rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore** mund të ishte rekomanduar një programim, menaxhim, monitorim dhe vlerësim i fondeve të BE-së që përfshin një qasje të përgjegjshme gjinore; investime publike të përgjegjshme gjinore; dhe një koordinim të donatorëve që përfshin financime për barazinë gjinore.

## **2. BAZAT E PROCESIT TË ANËTARËSIMIT**

### **2.1. FUNKSIONIMI I INSTITUCIONEVE DEMOKRATIKE DHE REFORMA E ADMINISTRATËS PUBLIKE**

#### **2.1.1 Demokracia**

- **Parlamenti** nuk i referohet nevojës për të siguruar që analizat e ndikimit gjinor të kryhen nga qeveria si pjesë e procesit legjislativ, ose për mbikëqyrje të përgjegjshme gjinore.
- **Financimi publik për shoqërinë civile** mund të kishte përmendur reagimin gjinor të fondeve të alokuara në përputhje me buxhetimin e përgjegjshëm gjinor.

#### **2.1.2 Reforma e Administratës Publike**

- Për sa i përket **zhvillimit dhe koordinimit të politikave**, ndërkohë që nuk vërehet "asnjë progres në përfshirjen e konsideratave gjinore në të gjitha politikat", kjo mund të ishte lidhur në mënyrë eksplicite me planifikimin, monitorimin, raportimin, vlerësimet e ndikimit *ex-ante* dhe menaxhimin e financave publike.
- Sa i përket **menaxhimit të financave publike**, nevoja për publikimin e deklaratave të buxhetit gjinor dhe të vlerësimeve të ndikimit mund të ishte më e qartë, në përputhje me Kornizën Gjinore të PEFA dhe OZHQ 5.c.1.
- Në lidhje me **shërbimin civil**, në raportin përmendet nënperfaqësimi i grave në pozitave vendimmarrëse, por nuk adresohet nevoja që nëpunësit civilë të kenë një kuptim më të mirë për zbatimin e rekrutimit të bazuar në merita dhe masat afirmative, sipas LBGJ-së.
- Për sa i përket **kapaciteteve dhe zhvillimit profesional**, raporti thekson mangësi, por nuk përmend në mënyrë eksplicite ndarjet e pamjaftueshme buxhetore dhe nevojën për të detyruar ndjekjen e

trajnimeve bazë për barazi gjinore, duke shfrytëzuar kurrikulat ekzistuese të Institutit Kosovar të Administratës Publike (IKAP).

- Në lidhje me **ofrimin e shërbimeve**, raporti mund të kishte inkurajuar një qasje të përgjegjshme gjinore dhe gjithëpërfshirëse ndaj tranzicionit digjital.

## 2.2. SUNDIMI I LIGJIT DHE TË DREJTAT THEMELORE

### 2.2.1 Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore

- Te pjesa për **funksionimin e gjyqësorit**:
  - Në raport thuhet se “Sistemi Informativ i Menaxhimit të Rasteve (SMIL) mundëson caktimin rastësor të lëndëve tek gjyqtarët dhe prokurorët.” Kjo nuk merr parasysh ndikimin negativ që mund të ketë në trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore, kur gjyqtarë dhe prokurorë të patrajnuar caktohen rastësisht për këto raste. SMIL duhet të përfshijë kritere që përcaktojnë kualifikimet minimale të gjyqtarëve dhe prokurorëve për rastet që kërkojnë njohuri dhe trajnime të specializuara në drejtësi.
  - Për cilësinë e drejtësisë, tabela për profesionistët e drejtësisë duhet të përfshijë të dhëna të ndara sipas gjinisë. Seksioni përmend punësimin e bazuar në merita dhe sfidat e rekrutimit të pakicave, por nuk përmend masat afirmative që duhet të merren për të siguruar një balancë gjinore.
  - Te efikasiteti, raporti përmend nevojën për përmirësimin e ndërveprueshmërisë ndërmjet SMIL dhe Sistemit Kombëtar të Centralizuar të Regjistrave Penale, por nuk thekson nevojën për të krijuar ndërveprim me sistemin e menaxhimit të rasteve për dhunën në familje dhe zgjerimin e tij për të përfshirë dhunën me bazë gjinore. Po ashtu, grafikët mbi efikasitetin e gjykatave nuk përfshijnë të dhëna të ndara sipas gjinisë, përkatësisht për viktimat dhe autorët.
  - Sa i përket trajtimit të rasteve të krimeve të luftës dhe personave të zhdukur, raportohet angazhimi i shoqërisë civile, por ky angazhim nuk lidhet në mënyrë eksplicite me Agjendën për GPS apo me angazhimin e OSHCG-ve.
- Te pjesa **lufta kundër korrupsionit**, grafikët dhe analizat mund të kishin përfshirë të dhëna të ndara sipas gjinisë.
- Te të **drejtat themelore**:
  - Për sa i përket promovimit dhe zbatimit të të drejtave të njeriut, raporti nuk përmend çështje që lidhen me të drejtat e grave si të drejta të njeriut. Po ashtu, grafiku mbi rastet e trajtuara nga organet e të drejtave të njeriut nuk është i ndarë sipas gjinisë. Raporti mund të kishte theksuar nevojën për të fuqizuar më tej një organ të barazisë për të adresuar diskriminimin, duke përfshirë atë gjinor dhe faktorët ndërthurës.
  - Si pjesë e ekzekutimit të sanksioneve penale, raporti nuk përmend nevojën për korrigjime që ndryshojnë marrëdhëniet e pushtetit gjinor me qëllim parandalimin e recidivizmit.
  - Te mbrojtja e të dhënave personale, grafiku nuk ofron të dhëna të ndara sipas gjinisë, dhe as nuk përmendet nevoja për mbrojtjen e të dhënave të përgjegjshme gjinore dhe për ndërgjegjësimin rreth saj.
  - Te **liria e shprehjes**, KE mund të kishte theksuar se Ligji i ri për KPM-në duhet të kërkonte një balancë gjinore, në përputhje me Ligjin për Barazinë Gjinore (LBGJ), dhe mund të kishte pranuar rekomandimet nga shoqëria civile lokale.
  - Lidhur me mosdiskriminimin, raporti përmend "gjuhën e urrejtjes për orientimin seksual", por nuk trajton mjaftueshëm diskriminimin me bazë gjinore. Po ashtu, nuk ofron të dhëna të ndara sipas gjinisë për rastet dhe nuk përmend diskriminimin gjinor në postimet në mediat sociale.
  - Lidhur me barazinë gjinore, diskutimi mbi legjislacionin për dhunën me bazë gjinore, përfshirë rehabilitimin e kryesve të veprave, mund të trajtohej më mirë si një çështje e sundimit të ligjit dhe drejtësisë. Sugjerimet e KE-së për financim dhe staf të mjaftueshëm nuk duhet të referohen vetëm tek Sekretariati, por të zbatohen për të gjitha zotimet lidhur me dhunën me bazë gjinore, përfshirë mbrojtjen, rehabilitimin dhe riintegrimin e viktimave/të mbijetuarve. Trajtimi i dobët i rasteve nga gjyqtarët dhe prokurorët duhet të trajtohej nën seksionin për funksionimin e

gjyqësorit dhe jo këtu. Sfidat specifike që përballen gratë në veri të Kosovës për qasje në drejtësi mund të ishin përmendur.

- Seksionet për të drejtat e fëmijës, personat me aftësi të kufizuara, mbrojtjen e pakicave, romët, ashkallitë dhe egjiptianët dhe të drejtat kulturore nuk ofrojnë një analizë të mjaftueshme gjinore. Raporti nuk trajton siç duhet diskriminimin që përjetojnë gratë rome, ashkali dhe egjiptiane, të cilat përballen me sfida të veçanta për shkak të ndërthurjes së racës, gjinisë dhe klasës, megjithë inputin e detajuar nga QKSGj. Seksioni për personat me aftësi të kufizuara duhej të kishte përfshirë nevojën për legjislacion të dytësor që përcakton kualifikimet minimale për asistentët personalë dhe siguron që ata të marrin të paktën pagën minimale, oraret e drejta të punës dhe kontributet për pension. Seksioni për pakicat gjithashtu ka mungesë të vëmendjes ndaj grupeve të ndryshme etnike, si goranët, turqit dhe boshnjakët.

## 2.2.2 Kapitulli 24: Drejtësia, liria dhe siguria

- Edhe pse seksioni për **luftën kundër krimit të organizuar** përmend trafikimin e qenieve njerëzore dhe përfshin të dhëna të ndara sipas gjinisë për policinë, ai mund të ofronte më shumë vëmendje për dallimet gjinore, siç janë pronësia e armëve të vogla (dhe ndikimi i saj në dhunën me bazë gjinore), natyra gjinore e trafikimit, balanca gjinore në prokurori, si dhe nevoja për vëmendje të përgjegjshme gjinore ndaj krimit kibernetik dhe digitalizimit. Seksioni dhe grafikët mund të ofrojnë gjithashtu të dhëna të ndara sipas gjinisë për autorët e krimit të organizuar, rastet e inspektoratit policor, **asetet kriminale të konfiskuara** dhe rastet e drogës.
- Seksionit për **trafikimin e qenieve njerëzore** i mungon vëmendja ndaj dallimeve gjinore.
- Seksioneve **Bashkëpunimi në fushën e drogës dhe lufta kundër terrorizmit** u mungojnë analizat gjinore në lidhje me parandalimin e krimit, ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin, si dhe të dhëna të ndara sipas gjinisë për të burgosurit. Po ashtu, ndikimet gjinore të lëvizjeve etnonacionale dhe ekstremizmit të djathtë nuk diskutohen në kontekstin e lëvizjeve anti-gjinore. Raporti mund të përmendte nevojën për masa parandaluese, rehabilituese dhe riintegruese të përgjegjshme gjinore.
- Seksionet për **migracionin e ligshëm dhe të parregullt, azilin dhe politikat e vizave** nuk kërkojnë një qasje të përgjegjshme gjinore ndaj legjislacionit, programeve dhe zbatimit të tyre. Nuk ofrohen të dhëna të ndara sipas gjinisë. Po ashtu, mund të ishte përmendur nevoja për përmirësimin e IT-së për të siguruar që AI të mos përfshijë paragjykimet racore ose gjinore që kontribuojnë në diskriminim.

## 2.3. ZHVILLIMI EKONOMIK DHE KONKURRUESHMËRIA

- Tabela fillestare mund të kishte përfshirë të dhëna të ndara sipas gjinisë për punësimin e popullsisë të moshës 15-64 vjeçare.

### 2.3.1. Ekzistimi i një ekonomie funksionale të tregut

- Shumica e nënsksioneve nuk i kushtojnë vëmendje aspektit gjinor. Qeverisjes ekonomike i mungon vëmendja ndaj aspektit gjinore, si në lidhje me politikat (taksat) dhe programet (Programi i Reformës Ekonomike). Stabiliteti makroekonomik nuk përmban asnjë analizë gjinore, përfshirë ato lidhur me remitancat, subvencionet për energjinë, apo buxhetet e shtetit. Në përgjithësi, Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) është një tregues i dobët i zhvillimit gjithëpërfshirës dhe të përgjegjshëm gjinor, pasi fsheh pabarazitë mes individëve, përfshirë gratë dhe burrat.
- Funksionimi i tregut të punës mund të kishte përfshirë të dhëna të ndara sipas gjinisë për të rinjtë (15-24 vjeç) që nuk janë të angazhuar në punësim, arsim ose trajnim (NEET). Nuk përmendet nevoja për skemën pilot të asistencës sociale me mjete të testuara të përgjegjshme gjinore.

### 2.3.2. Kapaciteti për të përballuar presionin konkurrues dhe ndikimin e forcave të tregut në BE

- Siç u tha, në pjesën për arsimin dhe inovacionin nuk përmendet në mënyrë të drejtpërdrejtë nevoja për arsim cilësor që transformon normat gjinore përmes kurrikulave të përmirësuara (duke minuar stereotipet dhe normat profesionale që kontribuojnë në dhunë), trajnimin e mësuesve dhe sigurimin e një balance gjinore të mësimdhënësve në të gjitha nivelet.

- Te Kapitali fizik dhe cilësia e infrastrukturës mund të ishte përmendur siguria e përgjegjshme gjinore në sektorët e transportit, energjisë dhe transformimit digjital.
- Te Struktura sektoriale dhe e ndërmarreve nuk përmendet se gratë priren të drejtojnë kryesisht NVM-të ose nuk diskutohen sfidat e tyre specifike gjinore në qasjen në financa.

## 2.4. PROKURIMI PUBLIK, STATISTIKAT, KONTROLLI FINANCIAR

### Kapitulli 5 –Prokurimi publik

- Sa i përket pjesës struktura institucionale dhe harmonizimi ligjor, KE mund të kishte theksuar nevojën për të inkorporuar në ligjin për prokurimin publik përkufizime dhe udhëzime më të qarta për zbatimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor. Ligji duhet të kërkojë një balancë gjinore tek organet e prokurimit.
- Në lidhje me zbatimin dhe kapacitetin për ta realizuar atë, KE mund të adresojë dobësitë në njohuritë e zbatimit të prokurimit publik, duke përfshirë masa afirmative që ndihmojnë në avancimin e barazisë gjinore, siç parashikohet me LBGj.

### Kapitulli 18 – Statistikat

- Siç u përmend më parë, në këtë kapitulli mund të ishte theksuar mungesa e kapaciteteve për analizën gjinore në ASK, disponueshmëria e kufizuar e statistikave të ndara sipas gjinisë (përfshirë të dhënat administrative), dhe ndarja e pamjaftueshme e të dhënave sipas gjinisë dhe grupeve të tjera sociale dhe demografike (p.sh., përkatësia etnike, mosha, vendndodhja rurale)..

### Kapitulli 32 –Kontrolli financiar

- Në kuadër të kontrollit të brendshëm financiar publik, Raporti duhet të kishte theksuar se Ligji për Menaxhimin e Financave Publike (MFP) dhe korniza përkatëse e politikave për kontrollin e brendshëm financiar publik duhet të inkorporojnë buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, në përputhje me Kornizën Gjinore PEFA dhe OZHQ 5.c.1. Kapacitetet për zbatimin e këtyre duhet të rriten më tej.
- Po ashtu, mund të ishte theksuar se, ndërkohë që buxheti i përgjegjshëm gjinor në auditimin e jashtëm ka pësuar përmirësime, është e nevojshme të arrihet një progres i mëtejshëm.

## 3. MARRËDHËNIET E MIRA FQINJËSORE DHE BASHKËPUNIMI RAJONAL

- Pavarësisht se në kapitull përmendet çështja e personave të zhdukur, një temë shumë e rëndësishme për shumë gra, aty nuk merret parasysh dimensionin gjinor i kësaj çështjeje. Ky aspekt mund të ishte përmendur në kontekstin e Procesit të Berlinit dhe Dialogut Kosovë-Serbi.

## 4. NORMALIZIMI I MARRËDHËNIEVE NDËRMJET KOSOVËS DHE SERBISË

- Në kapitull nuk përmendet agjenda për GPS-në, pjesëmarrja e pamjaftueshme e grave në Dialog, dhe i mungon një analizë e përgjegjshme gjinore për konfliktin. KE mund të kishte inkurajuar angazhimin e qeverisë për të përfshirë më shumë gra, të ndryshme nga grupe të tjera, në Dialogun 1 dhe 2. Raporti injoron rolin kyç të OSHCG-ve në kontributin për paqen; nuk thekson nevojën urgjente për përfshirjen e tyre në proceset e paqebërjes dhe pajtimit, siç parashikohet në Rezolutën 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së (RKSKB) mbi GPS, pavarësisht zotimeve të BE-së për këtë çështje. Raporti nuk adreson përjashtimin e nevojave dhe prioriteteve të grave nga Dialogu, as nuk thekson konsultimet e pamjaftueshme të qeverisë me gra dhe burra nga grupe të ndryshme.<sup>5</sup>

<sup>5</sup> RrGK, Një ulëse në tryezë: Kontributi i grave në proceset e ndërtimit të paqes në Kosovë dhe pritjet e tyre nga këto proces, 2021.



## 5. STANDARDET EVROPIANE

### GRUPIMI 2: TREGU I BRENDSHËM

#### Kapitulli 1 – Lëvizja e lirë e mallrave

- Në thirrjen e KE-së për një staf të mjaftueshëm mund të ishte përmendur balanca gjinore.

#### Kapitulli 2 – Liria e lëvizjes për punonjësit

- Në **Qasjen në tregun e punës** mund të ishin përfshirë të dhëna të ndara sipas gjinisë për lejet e punës.

#### Kapitulli 8 –Politika e konkurrencës

- Për sa i përket **ndihmës shtetërore**, KE mund të kishte theksuar se legjislacioni **duhet** të bazohet në një analizë gjinore dhe të jetë i përgjegjshëm gjinor.

#### Kapitulli 9 – Shërbimet financiare

- Për **financat digjitale dhe të qëndrueshme**, KE mund të kishte përfshirë të dhëna të ndara sipas gjinisë për garancitë dhe kreditë në fushën e efikasitetit të energjisë dhe bujqësisë së qëndrueshme.

#### Kapitulli 28 –Mbrojtja e konsumatorëve dhe e shëndetit

- Te **mbrojtja e konsumatorit**, mund të ishte përmendur mungesa e reagimit të mjaftueshëm gjinor në lidhje me shtrirjen e të drejtave të konsumatorëve dhe menaxhimin e të dhënave për raportimin digjital.
- Te **Shëndeti publik** mund të ishin përfshirë të dhëna të ndara sipas gjinisë për shpenzimet, në përputhje me buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, rezultatet shëndetësore, jetëgjatësinë, vdekshmërinë e fëmijëve dhe **pabarazitë** shëndetësore. Mund të ishte theksuar nevoja për publikimin e rregullt të të dhënave të ndara sipas gjinisë nga **sistemi digjital i informacionit shëndetësor** dhe regjistri i kancerit. Seksionit i mungonte analiza gjinore mbi mënyrën se si pabarazitë shëndetësore dhe shpenzimet e larta nga xhepi ndikojnë në mënyrë disproporcionale te gratë dhe burrat.

### GRUPIMI 3: KONKURRUESHMËRIA DHE RRIJJA GJITHËPËRFSHIRËSE

#### Kapitulli 10 –Transformimi digjital dhe mediat

- Te **shërbimet digjitale, besimin digjital dhe sigurinë kibernetike**, KE mund të kishte përmendur nevojën për një **qasje të përgjegjshme gjinore**. Ndërkohë që përmendet nevoja për të krijuar një mjedis më të sigurt në internet për fëmijët, duke përfshirë reagimin ndaj abuzimit seksual të fëmijëve në internet, ndikimi i ndryshëm mbi vajzat dhe djemtë nuk është trajtuar.
- Te **mediat**, referenca e KE-së për KPM-në nuk ka përfshirë heqjen e kërkesave për balancën gjinore nga ligji i ri, si pjesë e nevojës për burime njerëzore efektive.

#### Kapitulli 16 – Vënia e tatimeve

- KE mund të kishte theksuar nevojën për reforma në politikat tatimore që të jenë të **përgjegjshme gjinore**, si dhe se strategjia e re për të luftuar ekonominë joformale mund të ishte më e përgjegjshme ndaj aspektit gjinor, duke siguruar qasje “mos bëj dëm: për ata që janë më të cënueshëm.

#### Kapitulli 17 – Politika ekonomike dhe monetare

- Në lidhje me **politikën ekonomike**, KE mund të kishte theksuar nevojën për ta bërë buxhetin dhe kornizën buxhetore afatmesme më të përgjegjshme gjinore, në përputhje me zotimet për buxhetim të përgjegjshëm gjinor.

#### Kapitulli 19 – Politika sociale dhe punësimi

- KE vëren se “Kosova ende nuk ka miratuar ndryshimet në legjislacionin për **punën** dhe për **shëndetin dhe sigurinë në punë**, dhe për t’u harmonizuar më tej me legjislacionin e BE-së, duke përfshirë Direktivat e BE-së për balancën e jetës dhe punës.” Megjithatë, implikimet gjinore të kësaj nuk janë

trajtuar. Raporti tregon se “Qeveria ka ndarë fonde për të kompensuar nënat e reja në pushim të lehonisë,” por konteksti mund të ishte sqaruar për të shmangur ndonjë keqkuptim (p.sh., duke iu referuar mundësisht zgjerimit të masave të prezantuara gjatë periudhës së masave të COVID-19).

- Inspektorati i Punës mund të ishte inkurajuar të përmirësojë hetimet për diskriminimin me bazë gjinore dhe faktorë të tjerë, si dhe të trajtojë ekonominë joformale duke përdorur një [qasje të përgjegjshme gjinore](#).
- Për **politikën e punësimit**, KE mund të kishte theksuar rëndësinë e zbatimit të përgjegjshëm gjinor të ligjit të ri për punësimin, strategjisë së punës dhe tregut të punës për periudhën 2024-2028, si dhe në finalizimin e rregullores së re për masat aktive të tregut të punës.
- Sa i përket **përfshirjes sociale dhe mbrojtjes**, mund të ishte theksuar nevoja për testimin e mjeteve të përafërta për të përfshirë kritere të përgjegjshme gjinore, përveç treguesve të tjerë sociodemografikë.
- Seksionit për **cilësinë e shërbimeve sociale** i mungon analiza gjinore, duke përfshirë atë për nevojën për buxhetim të përgjegjshëm gjinor nga komunat për ndarjen e punëtorëve socialë për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale, sipas [protokollit të ri të shtetit për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale](#), dhe për të siguruar kapacitete adekuata të punëtorëve socialë për menaxhimin e duhur të rasteve të dhunës me bazë gjinore në përputhje me legjislacionin e ri, duke përdorur një qasje të përgjegjshme gjinore, me fokus te viktimat, sipas Konventës së Stambollit.
- Të dhënat për punën e fëmijëve mund të ishin ndarë sipas gjinisë.
- Për personat me aftësi të kufizuara, mund të ishte theksuar nevoja për të paguar pagën minimale për [asistentët personale](#) (kryesisht gra), për të siguruar të drejtat e tyre të punës, për të kontribuar në pensionet e tyre dhe për të përmirësuar kualifikimet e tyre për kujdesin ndaj të tjerëve.

## Kapitulli 20 –Politika për ndërmarrjet dhe industrinë

- Duhej theksuar sigurimi i zbatimit të përgjegjshëm gjinor të **politikave për ndërmarrjet dhe industrinë**.
- Në **instrumentet politike** përmenden grantet nga Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) për bizneset jo-shumicë, por nuk përmendet përqindja e granteve për bizneset e drejtuara nga gratë. Po ashtu, të dhënat në këtë seksion nuk janë të ndara sipas gjinisë. Do të ishte e përshtatshme që të përmendej [digjitalizimi](#) i shërbimeve elektronike të qeverisë në përputhje me perspektivën gjinore
- KE mund të kishte përfshirë analizën gjinore në lidhje me barrierat që gratë hasin për të pasur qasje në financa, si dhe përqindjen e kredive të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore që u jepen bizneseve në pronësi të grave.

## Kapitulli 26 – Arsimi dhe kultura

- Për shkallën e regjistrimit, KE mund të kishte paraqitur të dhëna të ndara sipas gjinisë, përkatësisë etnike dhe vendndodhjes rurale/urbane.
- **Edukimi dhe kujdesi i hershëm** për fëmijët mund të kishin përfshirë nevojën për zhvillimin e kurrikulave që sfidojnë normat gjinore dhe zgjerimin e mundësive për arsimin dhe kujdesin e hershëm.
- Për **cilësinë e arsimit**, KE mund të kishte përfshirë të dhëna të ndara sipas gjinisë nga rezultatet e testeve të Programit për Vlerësimin Ndërkombëtar të Studentëve dhe mund të kishte kërkuar [digjitalizimin e arsimit e përgjegjshëm gjinor](#).
- Sa i përket punësimit të stafit, EK mund të kishte përmendur nevojën për një balancë gjinore midis mësuesve në të gjitha nivelet, për certifikata në pedagogji që sfidojnë normat dhe stereotipat gjinorë, si dhe për një vlerësim të performancës që reflekton këto aspekte.
- Dallimet gjinore në lidhje me **përfshirjen** në arsim nuk janë përmendur.
- Po ashtu, nuk është përmendur nevoja për përmirësimin e të dhënave të disponueshme publikisht për vijimin dhe përfundimin e arsimit, të ndara sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike, zonës rurale/urbane e nivelit arsimor.

## GRUPIMI 4: AGJENDA E GJELBËR DHE LIDHSHMËRIA E QËNDRUESHME

### Kapitulli 14 –Politika e transportit

- Në pjesën që trajton **çështjet e transportit**, KE mund të kishte theksuar nevojën për strategji dhe programe që “përmirësojnë qëndrueshmërinë e transportit ndaj ndryshimeve klimatike” dhe që planet e mobilitetit urban të qëndrueshëm të jenë gjithëpërfshirëse dhe të përgjegjshme gjinore.
- Në pjesën për **transportin rrugor** mund të kishte përmendur shkurt nevojën për masa sigurie dhe mbrojtjeje që janë të përgjegjshme gjinore.

### Kapitulli 15 – Energjia

- Në pjesën për **tregun e brendshëm të energjisë**, KE mund të kishte theksuar nevojën për një regjistër të konsumatorëve të cenueshëm, si dhe për objektivat dhe qëllimet për mbështetje për 'familjet e varfra dhe konsumatorët e cenueshëm', duke përfshirë aspektet gjinore dhe të dhëna të ndara sipas gjinisë.
- Për **efikasitetin e energjisë**, KE mund të kishte përmendur nevojën për një qasje të përgjegjshme gjinore dhe përpjekjet e Kosovës në këtë drejtim.

### Kapitulli 21 – Rrjetet Trans-Evropiane

- Për planifikimin e Rrjetit Trans-Evropian të **Transportit**, mund të ishte theksuar nevoja për vlerësime të ndikimit mjedisor që janë të përgjegjshme gjinore.

### Kapitulli 27 – Mjedisi dhe ndryshimet klimatike

- KE mund të kishte përfshirë nevojën për strategji dhe plane të përgjegjshme gjinore për mbrojtjen e mjedisit, cilësinë e ajrit, **menaxhimin e mbetjeve, menaxhimin e ujit, mbrojtjen civile** nga fatkeqësitë dhe përshtatjen dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike; po ashtu, për Vlerësime të Ndikimit Mjedisor që janë të përgjegjshme gjinore.

## GRUPIMI 5: RESURSET, BUJQËSIA DHE KOHEZIONI

### Kapitulli 11 – Bujqësia

- Komisioni Evropian mund të kishte përmendur nevojën për politika të përgjegjshme gjinore dhe të dhëna të ndara sipas gjinisë.

### Kapitulli 22 – Politika rajonale dhe koordinimi i instrumenteve Strukturore

- Komisioni Evropian mund të kishte vënë në dukje nevojën për një koordinim më të përmirësuar ndërmjet Koordinatorit të Instrumentit Kombëtar për Asistencën e Para-Anëtarësimin (IPA), zyrtarëve të ministrisë përgjegjës për programimin IPA, Agjencisë për Barazi Gjinore dhe zyrtarëve të barazisë gjinore në nivel ministror, për planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e një programimi IPA më të përgjegjshëm gjinor.

## GRUPIMI 6: MARRËDHËNIET E JASHTME

### Kapitulli 30 – Marrëdhëniet e jashtme

- KE mund të kishte inkurajuar **tregtinë, politikën zhvillimore dhe ndihmën humanitare** të Kosovës të bazohet në analizën gjinore dhe të ishte në përputhje me Agjendën GPS.

## SHTOJCA I –MARRËDHËNIET NDËRMJET BE-së DHE KOSOVËS

- KE mund të kishte vërejtur në këtë Shtojcë se Programi Kombëtar për Integrimin Evropian për periudhën 2024-2028 ka përfshirë perspektivën gjinore, megjithatë ekzistojnë mundësi për përmirësime të mëtejshme.
- KE mund të kishte përfshirë informacion mbi financimin e BE-së për shoqërinë civile, të ndarë sipas gjinisë, për të lehtësuar monitorimin dhe raportimin mbi Planin e Veprimt Gjitor të BE-së III.

## SHTOJCA II - TË DHËNA STATISTIKORE

- Tabela mund të ofrojë të dhëna të ndara sipas gjinisë për popullsinë, ndërmarrjet aktive, krijimin dhe mbylljen e ndërmarrjeve, numrin e të punësuarve, popullsinë (shkalla e rritjes natyrore), vdekshmërinë foshnjore, shkallën e punësimit për personat e moshës 55-64 vjeç, punësimin sipas sektorëve kryesorë, shkallën e papunësisë tek të rinjtë, shkallën e papunësisë afatgjatë, pagat dhe mëditjet mesatare nominale mujore, varfërinë, makinat e pasagjerëve dhe abonimet e telefonave celularë.

## REKOMANDIMET KRYESORE PËR KOMISIONIN EVROPIAN

- *Të vazhdohet* të kërkohet përfshirja e perspektive gjinore në të gjithë kapitujt përkatës.
- *Të trajtohet* dhuna me bazë gjinore në seksionet e Sundimit të Ligjit dhe politikat sociale, duke ofruar rekomandime konkrete për institucionet përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit të ri.
- *Të sigurohet* përfshirja e të dhënave të ndara sipas gjinisë në të gjithë Raportin.
- *Të ushtrohet presion* mbi qeverinë që të sigurojë që të gjitha institucionet i dorëzojnë të dhënat ASK-së në kohën e duhur dhe që ASK-ja publikon rregullisht këto dhe të dhëna të tjera statistikore të ndara sipas gjinisë, në drejtim të lehtësimit të analizës gjinore.
- *Të vazhdohet të inkurajohet* qeveria që të institucionalizojë buxhetimin e përgjegjshëm gjinor si pjesë e reformave të vazhdueshme të administratës publike dhe ato të për financat publike, duke reflektuar përgjegjësitë e qeverisë për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor në të gjitha nivelet në mënyrë të qartë brenda amendamenteve të ardhshme në ligjin për financat publike, ligjin për prokurimin publik dhe ligjin për financat e pushtetit lokal. *Të inkurajohet* qeveria që të vë në dispozicion publikisht në kohën e duhur informacionin që ka të bëjë me buxhetimin e përgjegjshëm gjinor në përputhje me Qëllimin 5 të Zhvillimit të Qëndrueshëm, treguesin 5.c.1. dhe zotimet e Kornizës Gjinore të PEFA.
- *Të sigurohet* që zyrtarët të marrin parasysh LBGJ-në dhe masat e parapara afirmative gjatë punësimit në të gjitha nivelet dhe sektorët si pjesë e punësimit të bazuar në merita
- *Të inkurajohet* qeveria që të sigurojë një qasje të përgjegjshme gjinore ndaj tranzicionit digjital, si dhe të adresojë dhunën kibernetike me bazë gjinore, bazuar në [rekomandimet](#) e OSHCG-ve.
- *Të sigurohet* që në pjesët e raportit ku raportohet për sigurinë, siç është përmbledhja e përgjithshme e raportit dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore, të raportohet mbi kërcënimet e sigurisë të përjetuara në nivel lokal, nga OSHCG-të dhe nga gra dhe burra të ndryshëm në Kosovë dhe Serbi. Të konsultohet ekspertiza e organizatave “grassroots” dhe OSHCG-ve tjera që mund të japin kontributin përkatës.
- *Të sigurohet* një qasje gjithëpërfshirëse dhe ndërthurëse në Raport, e cila trajton aspektet gjinore dhe faktorë të tjerë si përkatësia etnike, mosha, vendndodhja rurale/urbane, aftësitë e kufizuara dhe faktorë të tjerë socio-demografikë. Po ashtu, të sigurohet që të dhënat për minoritetet dhe personat me aftësi të kufizuara të jenë gjithmonë të ndara sipas gjinisë.
- *Të vazhdohet* me konsultime me OJQ-të, veçanërisht OSHCG-të, për të mbledhur dëshmi në kohë që do të ndihmojnë në informimin e raporteve të ardhshme, përfshirë çështjet kryesore që lidhen me barazinë gjinore.



## SHTOJCA 1. VLERËSIMI SIPAS QASJES “DRITAT E SEMAFORIT”

Tabela në këtë shtojcë përdor qasjen “dritat e semaforit” për të vlerësuar se deri në çfarë mase është integruar perspektiva gjinore në secilin seksion dhe kapitull të Raportit. Ngjyra e gjelbër tregon përfshirjen e plotë të perspektivës gjinore, ngjyra e portokalltë tregon përfshirje të pjesshme, ndërsa ngjyra e kuqe tregon mungesën e përfshirjes së aspektit gjinor.

Kapitulli i	Seksioni	Përfshirja e plotë e perspektivës gjinore	Përfshirja e pjesshme e perspektivës gjinore	Mungesë e përfshirjes së perspektivës gjinore
<b>Gjetjet kryesore</b>				
Bazat e procesit të anëtarësisë mit	Demokracia	Qeverisje		Zgjedhjet; Kuvendi; integrimi në BE; shoqëria civile
	Reforma e administratës publike			Punësimi në shërbimin civil; digjitalizimi i shërbimeve; menaxhimi i financave publike
	Kapitulli 23 Gjyqësori dhe të drejtat themelore	Funksionimi i gjyqësorit	Të drejtat themelore: dhuna me bazë gjinore; kodi civil; LBGj	Lufta kundër korrupsionit; liria e shprehjes; personat me aftësi të kufizuara; minoritetet
	Kapitulli 24: Drejtësi, liri dhe siguri		Lufta kundër krimit të organizuar: trafikimi	Krimi kibernetik; policia
Zhvillimi Ekonomik dhe Konkurrueshmëria	Ekzistimi i një ekonomie funksionale të tregut			Taksa; menaxhimi i investimeve publike; rezultatet e tregut të punës; joformaliteti
	Kapaciteti për të përballuar presionin konkurrues dhe ndikimin e forcave të tregut në BE			Arsimi; digjitalizimi; kompanitë e vogla
	Kapitulli 5 – Prokurimi publik			
	Kapitulli 18 – Statistikat			
GRUPIMI 2: TREGU I BRENSHËM	Kapitulli 32 – Kontrolli financiar			
	Kapitulli 1 – Lëvizja e lirë e mallrave			Siguria e produktit; inspektimet
	Kapitulli 2 – Liria e lëvizjes për punonjësit			
	Kapitulli 3 – E drejta e themelimit dhe liria për të ofruar shërbime			
	Kapitulli 4 – Lëvizja e lirë e kapitalit			
	Kapitulli 6 – Ligji për shoqëritë tregtare			
	Kapitulli 7 – E drejta e pronësisë intelektuale			

<b>Kapitulli i</b>	<b>Seksioni</b>	<b>Përfshirja e plotë e perspektivës gjinore</b>	<b>Përfshirja e pjesshme e perspektivës gjinore</b>	<b>Mungesë e përfshirjes së perspektivës gjinore</b>
	Kapitulli 8 – Politika e konkurrencës			Ndihma shtetërore
	Kapitulli 9 – Shërbimet financiare			
	Kapitulli 28 – Mbrojtja e konsumatorëve dhe shëndetit			Mbrojtja e konsumatorit; mbulimi universal shëndetësor dhe shërbimet shëndetësore
<b>GRUPIMI 3: KONKURR UESHMËRI A DHE RRITJA GJITHËPËR FSHIRËSE</b>	Kapitulli 10: Transformimi digjital dhe media			E-qeverisja; siguria kibernetike
	Kapitulli 16 – Vënia e tatimeve			Politika tatimore; ekonomia joformale; punësimi, performanca e ATK-së; promovim dhe kapacitetet
	Kapitulli 17 – Politika ekonomike dhe monetare			Parashikimi makroekonomik në procesin buxhetor
	Kapitulli 19 – Politika sociale dhe punësimi		Ligji i punës - mosdiskriminimi dhe pushimi prindëror në punësim; inspektimet në sektorët me “rrezik të lartë”.	Nuk ka vëmendje ndaj pushimit të atësisë dhe atij për kujdestarët; ligji për shëndetin dhe sigurinë në punë; shërbimet sociale për dhunën me bazë gjinore; asistentë personalë për personat me aftësi të kufizuara
	Kapitulli 20 – Politika për ndërmarrjet dhe industri			Strategjia; Mbështetja e NVM-ve
	Kapitulli 25 – Shkenca dhe hulumtimi	Strategjia gjinore për hulumtime		
	Kapitulli 26 – Arsimi dhe kultura			Edukimi në fëmijërinë e hershme, cilësia, kurrikulat, trajnimi i mësimitdhënësve
	Kapitulli 29 – Sindikata e Doganës			Vende pune, vlerësim i performancës, promovim i bazuar në merita
<b>GRUPIMI 4: AGJENDA E GJELBËR DHE LIDHSH MËRIA E QËNDRU ESHME</b>	Kapitulli 14 – Politika e transportit			Strategjia e mobilitetit dhe plani i veprimit; ligji për rrugët; inspektimet; të dhënat e aksidenteve; plani i veprimit për transportin inteligjent; të drejtat e pasagjerëve
	Kapitulli 15 – Energjia			Ligjet, strategjitë dhe investimet
	Kapitulli 21 – Rrjetet Trans-Evropiane			Projektet e infrastrukturës
	Kapitulli 27 – Mjedisi dhe ndryshimet klimatike			Ligjet, strategjitë, kapacitetet
<b>GRUPIMI 5: RESURSE</b>	Kapitulli 11 – Bujqësia			Ligjet, kapacitetet
	Kapitulli 12 – Siguria ushqimore, politika			Numri, ekspertiza e stafit

Kapitulli i	Seksioni	Përfshirja e plotë e perspektivës gjinore	Përfshirja e pjesshme e perspektivës gjinore	Mungesë e përfshirjes së perspektivës gjinore
T, BUJQËSI A DHE KOHEZI ONI	veterinare dhe fitosanitare			
	Kapitulli 13 – Peshkimi dhe akuakultura			Numri, ekspertiza e stafit
	Kapitulli 22 – Politika rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore			Planifikimi, menaxhimi, monitorimi dhe vlerësimi i fondeve të BE-së; investimet publike; koordinimi i donatorëve
GRUPIMI 6: MARRËDHËNIET E JASHTME	Kapitulli 30 – Marrëdhëniet e jashtme			Plani i veprimit dhe politika zhvillimore dhe e ndihmës humanitare
<b>2. BAZAT E PROCESIT TË ANËTARËSIMIT</b>				
2.1. FUNKSIONI I INSTITUCIONEVE DEMOKRATIKE DHE REFORMA E ADMINISTRATËS PUBLIKE	2.1.1 Demokracia	Zgjedhjet: përafrimi i ligjit zgjedhor me LBGj; <b>Qeverisja; shoqëria civile</b>	Politikëbërja	Gjuha e urrejtjes në Kuvend; <b>Parlamenti</b> ; integrimi në BE; financimi publik i shoqërisë civile
	2.1.2 Reforma e Administratës Publike	<b>Menaxhimi i financave publike</b> ; gra në pozita të larta	<b>Zhvillimi dhe koordinimi i politikave; shërbimi civil</b>	Kapaciteti, zhvillimi profesional; ofrimi i shërbimit: e-qeverisja
2.2. SUNDIMI I LIGJIT DHE TË DREJTAT THEMELORE	2.2.1 Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore	<b>Organet menaxhuese</b> ; krimet e dhunës seksuale; parandalimi i torturës dhe keqtrajtimit; <b>Liria e shprehjes</b> ; ofruesi i shërbimeve publike; liria e tubimit dhe e shoqërimit; të drejtat pronësore; barazia gjinore; Personat LGBTIQ	Kodi Civil dhe Kodi i Procedurës Civile; mosdiskriminimi; të drejtat e fëmijës; personat me aftësi të kufizuara; romët, ashkalitë dhe egjiptianët	<b>SMIL</b> , tabela e cilësisë së drejtësisë për profesionistët e drejtësisë, rekrutimi; ndërveprueshmëria me sistemin e menaxhimit të rasteve për dhunën me bazë gjinore, efikasiteti i gjykatave; angazhimi i shoqërisë civile në drejtësinë tranzicionale; <b>lufta kundër korrupsionit</b> ; promovimi dhe zbatimi i të drejtave të njeriut; ekzekutimi i sanksioneve penale; mbrojtja e të dhënave personale; mjedisi legjislativ; mbrojtja e pakicave; të drejtat kulturore
	2.2.2 Kapitulli 24: Drejtësi, liri dhe siguri		Lufta kundër krimin të organizuar; trafikimi i qenieve njerëzore	Konfiskimi i aseteve kriminale; bashkëpunimi në fushën e drogës; lufta kundër terrorizmit; migrimi legal dhe i parregullt; azil; politika e vizave; Shengen

Kapitulli	Seksioni	Përfshirja e plotë e perspektivës gjinore	Përfshirja e pjesshme e perspektivës gjinore	Mungesë e përfshirjes së perspektivës gjinore
				dhe kufijtë e jashtëm
2.3. ZHVILLIMI I EKONOMIK DHE KONKURRUESHMËRIA	2.3.1. Ekzistimi i një ekonomie funksionale të tregut	Hendeku gjinor i punësimit	Të dhënat fillestare	Politikat e qeverisjes ekonomike, duke përfshirë taksat; stabiliteti makroekonomik, funksionimi i tregjeve të produkteve – joformaliteti; NEET
	2.3.2. Kapaciteti për të përballuar presionin konkurrues dhe ndikimin e forcave të tregut në BE			Edukimi dhe inovacioni; kapitali fizik dhe cilësia e infrastrukturës; struktura sektoriale dhe e ndërmarrjes
2.4. PROKURIMI PUBLIK, STATISTIKAT, KONTROLI FINANCIAR	Kapitulli 5 – Prokurimi publik			Organizimi institucional dhe harmonizimi ligjor; kapaciteti zbatues
	Kapitulli 18 – Statistikat	Të dhëna të ndara sipas gjinisë; Indeksi i Barazisë Gjinore		Ndarja sipas gjinisë dhe faktorëve të tjerë socialë dhe demografikë; kapacitetet
	Kapitulli 32 – Kontrolli financiar			Kontrolli i brendshëm financiar publik; Auditimi i jashtëm
<b>3. MARRËDHËNIET E MIRA FQINJËSORE DHE BASHKËPUNIMI RAJONAL</b>				
			Personat e zhdukur	Focesi Berlinit
<b>4. NORMALIZIMI I MARRËDHËNIEVE NDËRMJET KOSOVËS DHE SERBIË</b>				
				Agjenda për GPS, Dialogu, analiza e sigurisë gjinore
<b>5. STANDARDET EVROPIANE</b>				
GRUPIMI 2: TREGU I BRENDSHËM	Kapitulli 1 – Lëvizja e lirë e mallrave			Fusha e harmonizuar: legjislacioni sektorial
	Kapitulli 2 – Liria e lëvizjes për punonjësit			Qasje në tregun e punës
	Kapitulli 3 – E drejta e themelimit dhe liria për të ofruar shërbime			
	Kapitulli 4 – Lëvizja e lirë e kapitalit			
	Kapitulli 6 – Ligji për shoqëritë tregtare			
	Kapitulli 7 – E drejta e pronësisë intelektuale			
	Kapitulli 8 – Politika e konkurrencës			Ndihma shtetërore
	Kapitulli 9 – Shërbimet financiare			Financa digjitale dhe të qëndrueshme
	Kapitulli 28 – Mbrojtja e konsumatorëve dhe shëndetit			Mbrojtja e konsumatorit, shëndeti publik
GRUPIMI 3:	Kapitulli 10 – Transformimi			Shërbime digjitale; besimi



<b>Kapitulli i</b>	<b>Seksioni</b>	<b>Përfshirja e plotë e perspektivës gjinore</b>	<b>Përfshirja e pjesshme e perspektivës gjinore</b>	<b>Mungesë e përfshirjes së perspektivës gjinore</b>
<b>KONKURR UESHMËRI A DHE RRITJA GJITHËPËR FSHIRËSE</b>	digjital dhe media			digjital dhe siguria kibernetike; mediat
	Kapitulli 16 – Vënia e tatimeve			Politika tatimore; strategji e re për të luftuar ekonominë joformale
	Kapitulli 17 – Politika ekonomike dhe monetare			Politika ekonomike
	Kapitulli 19 – Politika sociale dhe punësimi			Inspektorati i Punës; politika e punësimit; përfshirja dhe mbrojtja sociale; cilësia e shërbimeve sociale; puna e fëmijëve; personat me aftësi të kufizuara
	Kapitulli 20 – Politika për ndërmarrjet dhe industri		Legjislacioni për punën dhe për shëndetin dhe sigurinë në punë Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë për bizneset në pronësi të grave	Politika për ndërmarrjet dhe industri; instrumentet e politikave; të dhëna; digjitalizimi
	Kapitulli 25 – Shkenca dhe hulumtimi	Mbështetja e MASHTI për studentet		
	Kapitulli 26 – Arsimi dhe kultura	APP		Shkalla e regjistrimit; edukimi dhe kujdesi në fëmijërinë e hershme; cilësia e arsimit; përfshirje; të dhëna për fëmijët në shkolla; sporti; kultura
	Kapitulli 29 – Sindikata e Doganës			Zyrtarët
<b>GRUPIMI 4: AGJENDA E GJELBËR DHE LIDHSH MËRIA E QËNDRU ESHME TY</b>	Kapitulli 14 – Politika e transportit			Çështjet e transportit; siguria rrugore; transporti hekurudhor
	Kapitulli 15 – Energjia			Tregu i brendshëm i energjisë; efikasiteti i energjisë
	Kapitulli 21 – Rrjetet Trans-Evropianë			Transport Network
	Kapitulli 27 – Mjedisi dhe ndryshimet klimatike			Mjedisi; çështjet horizontale; cilësia e ajrit; menaxhimi i mbeturinave; menaxhimi i ujit; mbrojtja civile; ndryshimet klimatike
<b>GRUPIMI 5: RESURSET, BUJQËSIA DHE</b>	Kapitulli 11 – Bujqësia			<b>Çështje horizontale</b>
	Kapitulli 12 – Siguria ushqimore, politikat veterinarë dhe fitosanitar			Inspektorët

<b>Kapitulli i</b>	<b>Seksioni</b>	<b>Përfshirja e plotë e perspektivës gjinore</b>	<b>Përfshirja e pjesshme e perspektivës gjinore</b>	<b>Mungesë e përfshirjes së perspektivës gjinore</b>
<b>KOHEZI ONI</b>	Kapitulli 13 – Peshkimi dhe akuakultura			Inspektimi
	Kapitulli 22 – Politika rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore			<b>Menaxhimi financiar; kapacitetet administrative; monitorimi dhe vlerësimi</b>
<b>GRUPIMI 6: MARRËDHËNIET E JASHTME</b>	Kapitulli 30 – Marrëdhëniet e jashtme			<b>Stafi; tregtia; politika e zhvillimit dhe ndihma humanitare.</b>
<b>SHTOJCA I - MARRËDHËNIET NDËRMJET BE-së DHE KOSOVËS</b>				Programi Kombëtar për Integritet Evropian për 2024-2028; Financimi i BE-së për shoqërinë civile
<b>SHTOJCA II - TË DHËNA STATISTIKORE</b>		Shkalla e punësimit 20-64 vjeç, shkalla e papunësisë		Popullsia, ndërmarrjet aktive, krijimi dhe mbyllja e ndërmarrjeve, numri i të punësuarve, popullsia (shkalla e rritjes natyrore), vdekshmëria foshnjore, shkalla e punësimit për personat e moshës 55-64 vjeç, punësimi sipas sektorëve kryesorë, shkalla e papunësisë tek të rinjtë, shkalla e papunësisë afatgjatë, pagat dhe mëditjet mesatare nominale mujore, varfëria, makinat e pasagjerëve dhe abonimet e telefonave celularë.